

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit **“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen,”**, mbështetur nga Komisioni Europian

Zhvilluar në bashkëpunim me Instituti i Studimeve Politike dhe Civil Rights Defenders

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Qëndresa Qytetare**

Zona e zbatimit: Tiranë, Durrës

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të amplifikojë pjesëmarrjen e të rinjve në procese politike dhe në Zgjedhjet Parlamentare 2020.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme, synohet të arrihen objektivat e posaçëm:

1. Ndërgjegjësimi për herë të parë në shkolla dhe universitete për rëndësinë e votimit, qeverisjes dhe sistemit politik;
2. Nxitja e debatit për përfshirjen e të rinjve në platformat elektorale të partive kryesore politike nëpërmjet edukimit demokratik.

Rezultatet të cilat synohen të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve të planifikuara janë:

1. Informimi i drejtpërdrejtë i 200 të rinjve, votues për herë të parë për rëndësinë e votës dhe dukuritë negative në zgjedhje me të cilat rrezikojnë të përballen përmes 6 seancave “Të flasim për votën”;
2. Informimi dhe ndërgjegjësimi i rreth 20.000 të rinjve përmes një fushate sensibilizuese në rrjetet sociale;
3. Të rinjtë më të informuar për ofertat politike, më pak indiferentë në ditën e zgjedhjeve dhe më të interesuar për jetën politike të vendit dhe partitë politike më të vëmendshme ndaj premtimeve dhe programeve qeverisëse për të rinjtë në fushatën zgjedhore.